

VENDIM
Nr. 355, datë 20.4.2018

PËR TRANSFERIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË ZONËN KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË, NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE, DHE VËNIEN NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, *GOJI BERRY*, AVOKADO DHE *FINGER LIME* NË ZONËN E KARAVASTASË, BASHKIA DIVJAKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin dhe përfshirjen e pronës së paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, kategoria e resursit “arë”, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me institucion administrues Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS).

2. Vënia në dispozicion e pasurisë së paluajtshme shtetërore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Ngritja e plantacionit me shegë, *goji berry*, avokado dhe *finger lime* në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”, me subjekt “Agro Iliria Group” sh.p.k., me NUIS/NIPT L51320033L, do të realizohet pasi të jetë nënshkruar marrëveshja e noterizuar e bashkëpunimit, ndërmjet shoqërisë “Agro Iliria Group” sh.p.k., me NUIS/NIPT L51320033L, dhe shoqërisë “Trema Engineering 2” sh.p.k., me NUIS/NIPT K21401004R, e tipit *joint-venture*, ku të jetë përcaktuar qartë angazhimi i subjektit “Trema Engineering 2” sh.p.k., me NUIS/NIPT K21401004R, për të kryer investimin dhe angazhimet e tjera të palëve për realizimin e këtij projekti.

3. E drejta e përdorimit të tokës shtetërore të kategorisë së resursit “arë” nga investitori strategjik “Agro Iliria Group” sh.p.k., me NUIS/NIPT L51320033L, detyrimet dhe kushtet e përdorimit do të bazohen në vendimin nr. 6/4, datë 19.4.2018, të Komitetit të Investimeve Strategjike, në marrëveshjen e garancive financiare dhe kontratën e qirasë, që do të nënshkruhen ndërmjet ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit investues.

4. Vënia në dispozicion e pasurisë së paluajtshme shtetërore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Ngritja e plantacionit me shegë, *goji berry*, avokado dhe *finger lime* në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”, me subjekt “Agro Iliria Group” sh.p.k., me NUIS/NIPT L51320033L, bëhet për 30 (tridhjetë) vjet, me tarifën 1 euro/kontrata. Afati i përdorimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës së qirasë, ndërmjet ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit investues.

5. Aplikimi për leje/licenca/autorizime për realizimin e investimit strategjik “Ngritja e plantacionit me shegë, *goji berry*, avokado dhe *finger lime* në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë” realizohet sipas legjislacionit të investimeve strategjike.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Bashkia Divjakë dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI I
ZONA KADASTRALE NR. 2085 KARAVASTA E RE,
NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS,
BASHKIA DIVJAKË

Zona 1				
Nr.	Nr. pasurie	Sip.	Harta sipas Nomenklaturës	Pronari
1	143/1	17,036	K-34-111-111-B	Shtet
2	144/1	3,144	K-34-111-111-B	Shtet
3	145/1	7,640	K-34-111-111-B	Shtet
4	145/12	1,057	K-34-111-111-B	Shtet
5	146/1	9,234	K-34-111-111-B	Shtet
6	146/9	14,583	K-34-111-111-B	Shtet
7	147/1	7,030	K-34-111-111-B	Shtet
8	148/1	5,480	K-34-111-111-B	Shtet
9	148/3	117,000	K-34-111-111-B	Shtet
10	149/1	2,074	K-34-111-111-B	Shtet
11	149/6	16,450	K-34-111-111-B	Shtet
12	150/1	1,140	K-34-111-111-B	Shtet
13	150/6	5,335	K-34-111-111-B	Shtet
TOTALI		207,203		

Zona 2				
Nr.	Nr. pasurie	Sip.	Harta sipas Nomenklaturës	Pronari
1	162/1	44,728	K-34-111-111-A	Shtet
2	162/4	55,704	K-34-111-111-A	Shtet
3	163/1	44,175	K-34-111-111-A	Shtet
4	163/4	54,687	K-34-111-111-A	Shtet
5	164/1	47,288	K-34-111-111-A	Shtet
6	164/3	55,402	K-34-111-111-A	Shtet
7	165/1	128,193	K-34-111-94-D	Shtet
8	166/1	95,008	K-34-111-94-D	Shtet
9	167/1	59,642	K-34-111-94-D	Shtet
10	168/2	145,923	K-34-111-94-D	Shtet
11	169/3	131,780	K-34-111-94-D	Shtet
12	170/3	125,106	K-34-111-94-D	Shtet
13	171/2	123,300	K-34-111-110-B	Shtet
14	172/4	91,218	K-34-111-110-B	Shtet
15	181/4	92,634	K-34-111-110-B	Shtet
16	182/3	96,416	K-34-111-110-B	Shtet
17	183/3	90,084	K-34-111-110-B	Shtet
18	184/2	10,674	K-34-111-110-B	Shtet
19	187/1	77,400	K-34-111-111-C	Shtet
20	188/1	8,960	K-34-111-111-C	Shtet
21	188/3	104,975	K-34-111-111-C	Shtet
22	189/1	117,187	K-34-111-111-C	Shtet
23	190/1	24,570	K-34-111-110-B	Shtet
24	190/4	104,339	K-34-111-110-B	Shtet
25	191/1	54,822	K-34-111-110-B	Shtet
26	191/3	84,860	K-34-111-110-B	Shtet
27	192/1	57,692	K-34-111-110-B	Shtet
28	192/4	54,565	K-34-111-110-B	Shtet
TOTALI		2,181,332		

Zona 3				
--------	--	--	--	--

Nr.	Nr. pasurie	Sip.	Harta sipas Nomenklaturës	Pronari
1	193/1	26,578	K-34-111-111-A	Shtet
2	193/3	3,493	K-34-111-111-A	Shtet
3	194/1	78,784	K-34-111-111-A	Shtet
4	195/1	24,680	K-34-111-111-C	Shtet
5	196/1	63,429	K-34-111-111-C	Shtet
6	197/1	97,012	K-34-111-111-C	Shtet
7	198/1	97,143	K-34-111-111-C	Shtet
8	199/1	90,715	K-34-111-111-C	Shtet
9	200/1	96,009	K-34-111-111-C	Shtet
10	201/1	105,300	K-34-111-111-C	Shtet
11	202/1	110,881	K-34-111-111-D	Shtet
12	203/1	101,928	K-34-111-111-C	Shtet
13	204/1	29,279	K-34-111-111-D	Shtet
14	205/1	117,250	K-34-111-111-D	Shtet
15	206/1	117,184	K-34-111-111-D	Shtet
16	207/1	5,880	K-34-111-111-D	Shtet
17	207/5	70,250	K-34-111-111-D	Shtet
18	208/1	31,185	K-34-111-111-D	Shtet
19	208/3	62,250	K-34-111-111-D	Shtet
20	209/1	120,487	K-34-111-111-D	Shtet
TOTALI		1,449,717		

Tabelë përmbledhëse

Zona	Parcelat			Sipërfaqja	
	Fillon	Mbaron		m ²	Ha
Zona 1	143/1	150/6		207,203	20.7203
Zona 2	162/1	192/4		2,181,332	218.1332
Zona 3	193/1	209/1		1,449,717	144.9717
			TOTALI	3,838,252	383.8252